



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.10.2023

Nr: 188

Ora: 14:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 34, DATË 19.10.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.10.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES:	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
OBJEKT:	Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Kamëz
BAZË LIGJORE:	Neni 19 pika 1 shkronja “c” dhe neni 21 pika 1 shkronja “dh” të K.Zgjedhor

Data: 26.10.2023 Nr: 188
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës nr. 34, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë denoncime nga organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) nga e cila është depozituar indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike, nga 1 (një) institucion publik, për të cilin pretendohet se nuk është raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

2. Indicia është marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

3. Në denoncimin e regjistruar me nr. 402 ID, pretendohet si më poshtë vijon:

“Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit “Kamza Lexon”, me një larmishmëri aktiviteteve dhe emocioneve, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm : Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar); Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar); Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor. Ju ftojmë të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë!

#KamzaLexon #PanairiLibrit Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LDR6DJfCDëZhëFPzMXMDCBFtënxp65QoM5SËpdDaLy5MeDkFËvË7615kZp2qvsfTI&id=100044332874482

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid031mvLëMe7GYv18NEY5ALfëvEhFe4bahDtXF7ooYcTdkY1z2ËvP5fËtvPGG1mNALcal&id=100077339029573

4. Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 686, datë 08.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 402 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 402 ID.

5. Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin e regjistruar me nr. 402 ID, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, sipas Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

provohet se nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaria e kryer nga subjekti i denoncuar përbën veprimtari publike në kuptim të nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

6. Për këtë arsye, me anë të vendimit nr. 797, datë 06.10.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur t'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, gjobë në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz.
7. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të kërkesës së regjistruar me nr. 34, datë 19.10.2023, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë duke e mbështetur këtë propozim në nenin 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor.
8. KQZ caktoi me short anëtarin e KAS-it, z. Ledio Braho, si relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 34, datë 19.10.2023 të Komisionerit. KAS, në seancën paraprake, vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më datë 26.10.2023, ora 14:00.
9. Seanca e datës 26.10.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Palët janë njoftuar rregullisht konform ligjit dhe nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi këto prova shkesore:
 - Kërkesën nr. 34, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Vendimin nr. 797, datë 06.10.2023, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj personit përgjegjës, për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023";
 - Denoncimin nr. 402 ID, si dhe foto/prova link bashkëlidhur;
 - Njoftimet/komunikimi nëpërmjet postës elektronike për zhvillimin e senacave dhe kërkesa për informacion me personat objekt hetimi;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton se:

1. Shkelja e konstatuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për të cilën kërkon sanksion administrativ ka në fokus zhvillimin e një veprimtarie publike, e cila sipas Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Nga provat e administruara në hetimin administrativ të kryer nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, rezulton se personi përgjegjës për raportimet në Bashkinë Kamëz, pasi është vënë në dijeni të denoncimit në lidhje me mosraportimin e këtij aktiviteti publik, i është përgjigjur elektronikisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve se *“Nga ana e bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë në fjalë me karakter publik. Sa më sipër, nga ana e bashkisë Kamëz është raportuar në ndërfaqen e raportimeve Panairi i Librit “Kamza Lexon”. Paqartësia nga denoncuesit është krijuar për shkak se ky aktivitet është shtyrë dhe është kryer disa ditë pas datës së cilës është raportuar. Në ndërfaqen e raportimeve do të shihet që është raportuar ky aktivitet”*.
3. Në lidhje me këtë fakt të pretenduar nga personi përgjegjës për raportimet në Bashkinë Kamëz rezulton se në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga Bashkia Kamëz, në datë 23 mars 2023 është raportuar aktiviteti me titull “Panairi i Librit Bashkia Kamëz”. Sipas raportimit të vetë Bashkisë Kamëz, rezulton gjithashtu se aktivitetit zgjat 3 ditë radhazi (14-15-16 prill 2023) dhe është viti i dytë i realizimit të tij. Vendi i aktivitetit do të jetë në sheshin “Nënë Tereza” në Kamëz, folësit kryesorë do të jenë Rakip Suli, Liridon Pjetra dhe Rigelsa Gupe që respektivisht janë kryetari i bashkisë Kamëz, shkrimtar dhe Drejtoresha e Pallatit të Kulturës, por po ashtu si pjesëmarrës do të jenë edhe shkrimtarë të tjerë dhe qytetarë.
4. Nga provat e paraqitura nga denoncuesi, të administruara edhe gjatë hetimit administrativ nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, që janë dy linqe nga rrjeti social Facebook, rezulton

se Bashkia Kamëz, në datë 28 prill 2023, ka publikuar në këtë rrjet social një njoftim me përshkrimin “Tradita vazhdon... Në datat 5, 6 dhe 7 Maj, takohemi së bashku në edicionin e dytë të Panairit të Librit “Kamza Lexon”, ku përveç ekspozimit të librave do të organizohen 20 takime promovuese në stendën e ngritur në sheshin “Nënë Tereza”. 6 çmime, 25 shtëpi botuese dhe me pjesëmarrjen e mbi 40 skrimtarëve, ju ftojmë të na bashkoheni për ta bërë këtë edicion edhe më fantastik se edicionin e parë. #KAMZALEXON” të cilin gjithashtu e shoqëron me një fotografi me përmbajtje “Panairi II i Librit. Kamza Lexon. 5, 6, 7 Maj 2023, Sheshi “Nënë Tereza”, Kamëz” dhe kryetari i bashkisë Kamëz z. Rakip Suli, në datë 5 maj 2023, ka publikuar në këtë rrjet social një njoftim me përmbajtje “1, 2, 3... Filluam! Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit “Kamza Lexon”, me një larmishmëri aktiviteteve e emocioneve, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm:

Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar);

Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar);

Namik Dokle (Politikan dhe gazetar);

Fatmir Toçi (President i shtëpisë botuese "Toena", Kryetar i "Shoqatës së Botuesve Shqiptarë");

Agim Baçi (Kritik letrar, shkrimtar);

Diana Kastrati (Pedagoge, përkthyes, Botimet Arbëreshe);

Frano Kulli (Studies, Botime Fishta);

Primo Shllaku (Shkrimtar, studiues, gjuhëtar, poet);

Sokol Cunga (Përkthyes, historian, Arkiva e shtetit);

Majlinda Toçi (Studiuese, Biblioteka Kombëtare);

Monika Stafa (Gazetare);

Fatmir Gjestila (Shkrimtar);

Dritan Sulçebe (Diplomat, shkrimtar);

Eleana Zhako (Përkthyes, shkrimtare);

Arta Marku (Gazetare, përkthyes);

Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor.

Ju ftojmë të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë!

#KamzaLexon

#PanairiiLibrit”.

Ky publikim është shoqëruar edhe me 18 fotografi që duket se janë pikërisht nga aktiviteti i sipërcituar.

5. Nga faktet e sipërcituara del qartë që nga ana e Bashkisë Kamëz, raportimi në ndërfaqen e KQZ për zhvillimin e aktivitetit *“Panairi II i Librit – Kamza Lexon”* është bërë për datat 14-15-16 prill 2023 ndërkohë që nga publikimet në rrjetin social Facebook të vetë Bashkisë Kamëz dhe të kryetarit të Bashkisë Kamëz rezulton se aktiviteti është zhvilluar në data 5-6-7 maj 2023.
6. Pavarësisht kësaj, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, edhe pse gjatë hetimit administrativ nuk ka arritur të identifikojë asnjë provë që janë zhvilluar dy aktivitete, si ai i datave 14-15-16 prill 2023, ashtu edhe ai i datave 5-6-7 maj 2023 ka arritur në përfundimin se *“Bashkia Kamëz, në përgjigjen e saj ka sqaruar se aktiviteti është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por nga hetimi administrativ vërehet se bashkia Kamëz, ka kryer dy aktivitete të këtij lloji për të cilat rezulton se në rastin e parë është raportuar në ndërfaqe ndërsa për eventin “Kamza Lexon” nuk është bërë raportim”*.
7. Nga shqyrtimi administrativ në KAS, nuk u arrit të provohej se aktiviteti i datave 5-6-7 maj 2023 është organizuar nga Bashkia Kamëz, por ajo çka del e qartë nga të gjitha provat e shqyrtuara edhe nga hetimi administrativ i vetë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është se aktiviteti i raportuar në ndërfaqen e KQZ që do të zhvillohej në datat 14-15-16 prill 2023, në fakt është zhvilluar në datat 5-6-7 maj 2023. Pavarësisht mospërputhjes së datave të zhvillimit të aktivitetit për shkak të gabimit në raportim, apo të ndryshimit të mëvonshëm të datave nga organizatori i aktivitetit, nuk e shndërron këtë aktivitet si të zhvilluar dy herë apo në dy aktivitete të ndryshme siç është konsideruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
8. Në nenin 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se ***“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën***

katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.

Pra, detyrimi për raportim në këtë rast është zbatuar nga ana e Bashkisë Kamëz, edhe afati kohor paraprak për raportimin e aktivitetit është respektuar, por datat e zhvillimit të aktivitetit nuk përputhen, ndërkohë që çdo e dhënë tjetër përputhet, çka e bind KAS-in se bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të raportuar dhe të zhvilluar në data të mëvonshme nga institucioni organizator.

9. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kërkesën e tij drejtuar KAS nuk ka pretenduar se zhvillimi i aktivitetit në data të ndryshme nga ato të raportuara në ndërfaqen e KQZ-së është në kushtet e shkeljes së ndonjë dispozite të K.Zgjedhor, por pa arritur të provojë se bëhet fjalë për dy aktivitete të ndryshme, ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë për personin përgjegjës në Bashkinë Kamëz për mosraportimin e një aktiviteti publik në zbatim të nenit 92 pika 1 të K.Zgjedhor.

10. Ndodhur në këto kushte, për KAS, me provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ, nuk krijohet bindja se jemi në rastin e një aktiviteti të paraportuar në kuptim të nenit 92 pika 1 të K.Zgjedhor, por jemi në rastin e zhvillimit të një aktiviteti datat e të cilit nuk përputhen mes raportimit dhe zhvillimit. Si K.Zgjedhor, ashtu edhe vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” nuk e rregullon rastin e ndryshimit të datave të aktiviteteve të raportuara, pra që ta konsiderojë shkelje mosndryshimin e datave (nëse është e lejueshme nga ndërfaqja e KQZ) apo mosraportimin e tij si një aktivitet të ri.

11. Si K.Zgjedhor ashtu dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk parashikojnë asnjë rregullim për mënyrën se si duhet të veprojnë subjektet raportuese, në rastet kur për rrethana të caktuara ato janë të detyruara të ndryshojnë datën, orën, vendin apo agjendën e veprimtarisë. Një vakum i tillë në kuadrin rregullator, sa kohë që nuk plotësohet, e çliron subjektin raportues nga çdo përgjegjësi e tillë për mosndryshim të një raportimi të mëparshëm.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21 pika 1 shkronja “dh” dhe 172 pika 1 të K.Zgjedhor, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës nr. 34, datë 19.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

U shpall sot, më datë 26.10.2023.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar